



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

FORUMI I SOLAREVE NË KOSOVË

Promovimi i Investimeve në
Energji të Ripërtërishme

**21-22 KORRIK
2022**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Hyrje

Duke u mbështetur në suksesin e Forumit të parë Solar të Kosovës të organizuar në korrik të vitit 2021, Ministria e Ekonomisë, me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), organizon ngjarjen **Forumi i Solareve në Kosovë: Promovimi i Investimeve në Energji të Ripërtërishme**. Forumi do të nxjerrë në pah mjedisin e favorshëm të biznesit dhe mundësitë për investime në tregjet në rritje të konsumatorëve prodhues dhe të vetë-konsumit për energjinë solare në shkallë të vogël, si dhe projektet e ardhshme me kapacitete të mëdha diellore në Kosovë.

Viti 2022 është një vit i rëndësishëm për tranzicionin e Kosovës drejt burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE), sepse këtë vit ripërcaktohet e ardhmja e saj energjetike. Forumi i Solareve në Kosovë grumbullon në një vend të gjithë akterët kryesor vendor dhe ndërkombëtarë të sektorit energjetik, investitorët, bankat komerciale, bizneset dhe zhvilluesit e BRE-ve, zyrtarët qeveritarë dhe politikëbërësit, për të diskutuar dhe promovuar investimet për energjinë e ripërtërishme.

Forumit ndjek momentumin e ndryshimeve klimatike në mbarë sektorin energjetik, duke riafirmuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për të siguruar progres drejt përmbushjes së caqeve kombëtare për investimet në BRE dhe për dekarbonizim. Ky do jetë një rast i mirë edhe për të ndarë këndvështrimet rajonale për zhvillimin e BRE-ve në mbarë Ballkanin Perëndimor.

Forumit do të paraqesë edhe **Panairin e Solareve** ku kompanitë kryesuese të vendit për energjinë solare, bankat komerciale, agjencitë zhvillimore ndërkombëtare dhe lojtarë të tjerë të BRE-ve, mund të paraqesin dhe promovojnë shërbimet dhe produktet e tyre.

Panairi u ofron pjesëmarrësve një mundësi konkrete që të njihen me gamën e gjerë të ekspertizës, njohurive dhe mundësive të disponueshme në Kosovë për zhvillim të projekteve konkrete për energji të ripërtërishme.

Përkushtimi i Kosovës ndaj dekarbonizimit

Si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë, Republika e Kosovës është duke e harmonizuar legjislacionin e saj me dispozitat e Bashkimit Evropian (BE) për klimën, energjinë dhe mjedisin.

Qeveria e Kosovës miratoi Deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor në vitin 2020 – duke u zotuar të arrijë zero neto emetimet deri në vitin 2050 dhe të hedhë hapa që t'i afrohet krijimit të një mjedisi të gjelbër dhe të shëndetshëm për qytetarët e saj.

ZHVILLIMET E VAZHDOESHME NË SEKTORIN ENERGETIK TË KOSOVËS

Strategjia e Energjisë 2022-2031

Strategjia e Energjisë e Qeverisë së Kosovës paraqet një vizion ambicioz për tranzicionin e drejtë energjetik të vendit për 10 vjetët e ardhshme.

Përmes kësaj strategjie, Qeveria merr rolin udhëheqës drejt një shërbimi modern, të besueshëm dhe të përballueshëm të energjisë elektrike për të gjithë qytetarët, dhe vendos politika që promovojnë një agjendë kuptimplotë për ndryshimet klimatike dhe mbrojnë mirëqenien si pjesë e evolucionit drejt një të ardhmeje me energji të qëndrueshme.

Kjo strategji është e paprecedentë: ajo nuk parashikon kapacitete të reja të linjtit në Kosovë, planifikon të vendosë çmimin e karbonit që do të përfshihet në koston e përgjithshme të funksionimit të impianteve ekzistuese me thëngjill, dhe bën parashikime ambicioze për futjen në përdorim të burimeve të ripërtërishme të energjisë, veçanërisht me erë dhe solare.

Objektivat e Strategjisë së Energjisë

- Rritja e kapaciteteve gjeneruese nga burimet e ripërtërishme me së paku 35% të konsumit të elektricitetit në vend, dhe arritja e kapacitetit prej 1,400 MW nga energjia me erë dhe solare;
- Zvogëlimi i emetimeve të gazrave serrë me së paku 32%;
- Dekomisionimi i një njësie të Kosova A deri më 2026 dhe transformimi i njësive tjera në kapacitete rezervë deri më 2028; dhe
- Investim i dukshëm për të përmirësuar eficiencën e energjisë për të ulur konsumin dhe shkarkuar barrën për furnizim.

Ankandi i parë për energji të ripërtërishme solare FV në vitin 2022

Ankandi i parë konkurrues i Kosovës për energjinë elektrike të prodhuar me impiante solare fotovoltaike (FV) është planifikuar për vitin 2022. Ministria e Ekonomisë parashikon dhënien e kontratave për projektimin dhe zhvillimin e deri në 100 megavat (MW) të impianteve solare FV nëpërmjet një procesi ankandi të hapur dhe transparent, duke i lejuar ofertuesve të propozojnë instalime në toka publike dhe/ose private.

Ofertuesit që ofrojnë çmimin më të ulët dhe që plotësojnë kërkesat e tenderit, do të shpërblehen me marrëveshjen për blerje të energjisë elektrike me çmim të garantuar të blerjes së energjisë elektrike.

Ankandi i parë solar pritet të tërheqë investitorë privatë dhe zhvillues të energjisë së ripërtërishme me përvojë, lokale dhe të huaj, si dhe t'i hapë derën tenderimit të kapaciteteve të reja energjetike vendore përmes proceseve konkurruese. Në fund të fundit, Kosova do të diversifikojë miksën e vet energjetik dhe do të ketë çmime më të përballueshme.

Në të ardhmen, ankandet përfaqësojnë një mekanizëm të rëndësishëm për arritjen e caqeve të Kosovës për energji të ripërtërishme. Ankandi i parë do t'i hapë rrugën tenderimit për zbatimin e skemave më të mëdha konkurruese në Kosovë të planifikuara për vitin 2023.

Ligji për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

Duke e pranuar nevojën për nxitje të investimeve dhe zhvillimin e transaksioneve të burimeve të ripërtërishme të energjisë (BRE) përmes mbështetjes me politika dhe legjislacion, Ministria e Ekonomisë dhe partnerët e saj janë në proces të hartimit të një Ligji të ri për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë si një mjet thelbësor për nxitje të investimeve të nevojshme dhe lehtësim të tranzicionit të drejtë energjetik në Kosovë. Projektligji është hartuar për të siguruar strukturën e nevojshme të zhvillimit dhe financimit të projekteve për të ndihmuar në krijimin e një vazhdimësie të projekteve të financuara për BRE.

Projektligji për BRE-të do të konsolidojë legjislacionin ekzistues për energjinë dhe do të trajtojë çështjet më urgjente rreth zhvillimit të projekteve, duke hequr masat e rënda dhe të tepërta burokratike që i pengojnë investitorët privatë dhe publikë. Puna për hartimin e Ligjit për BRE-të po zhvillohet në koordinim të ngushtë mes Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Grupit Punues të krijuar nga Ministria e Ekonomisë.

Ligji i ri synon të ofrojë procese dhe masa të qarta për t'u dhënë investitorëve më shumë besim për të investuar në vet-prodhim përmes BRE-ve. Ai do të adresojë çështje të rëndësishme për të ndihmuar nxitjen e investimeve në sektorin energjetik, zgjerimin e biznesit, dhe krijimin e vendeve të reja të punës në Kosovë. Kjo do t'u mundësojë kompanive kosovare t'i bashkohen tregut më të gjerë rajonal të BRE-ve dhe sektorit të biznesit që po zhvillohet si pjesë kritike e të ardhmes energjetike të Evropës.

Konsumatorët prodhues me impiante solare FV

Duke qenë një prej nxitësve kryesorë të tranzicionit drejt energjisë së ripërtërishme, prosumatorët do të luajnë një rol të rëndësishëm në kornizën e re energjetike të Kosovës. Prosumatorët zakonisht e konsumojnë pjesën më të madhe të energjisë elektrike të gjeneruar nga sistemet e tyre solare FV, kurse tepricën e kthejnë në rrjet kundrejt krediteve.

Modeli i prosumatorit ofron një mënyrë me kosto efektive që konsumatorët të marrin pjesë në tregun në zhvillim të energjisë elektrike, duke e mbuluar vetë-konsumin e tyre dhe duke kontribuar në rritjen e pjesës së energjisë së ripërtërishme në konsumin përfundimtar të energjisë elektrike, si dhe duke reduktuar humbjet në rrjetin e shpërndarjes. Konsumatorët prodhues do të ndihmojnë që kostot e tyre dhe kostot e sistemit të mbahen të ulëta, duke kontribuar në sigurinë energjetike të Kosovës dhe reziliencën ndaj klimës.

Rregulli për prosumatorët

Mbështetja për tregun e prosumatorëve në Kosovë kërkon gjithnjë e më shumë masa rregullatore që do të ndihmojnë akomodimin e kërkesës aktuale dhe atë të ardhshme, si dhe do të krijojnë një bazë të shëndoshë për t'i mbështetur plotësisht klientët si vet-konsumatorë të energjisë së ripërtërishme. Këto masa dhe përditësime rregullatore janë në përputhje të plotë me legjislacionin e ri të Bashkimit Evropian, i cili kërkon krijimin e një mjedisi të favorshëm për pjesëmarrjen aktive të konsumatorëve në tregun e energjisë elektrike, si dhe mundësimin e zgjerimit të energjisë së ripërtërishme.

Nisur nga legjislacioni aktual dhe bazuar në analizën e praktikave më të mira të aplikuara në Evropë dhe rajon, Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është në proces të zhvillimit të *Rregullit për Konsumatorët Prodhues*. Ky rregull do të sigurojë nivel të avancuar rregullimi, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të integruar, për të gjitha çështjet që lidhen me vetë-konsumimin. Gjithashtu, do të sigurojë kornizë rregullatore të përshtatshme dhe të mjaftueshme për t'i trajtuar kërkesat në rritje në këtë sektor. Rregulli për Prosumatorët do të përcaktojë parimet dhe mekanizmin e rregulluar për mbështetjen e konsumatorëve të energjisë elektrike që në objektet e tyre dhe bazuar në teknologjinë e ripërtërishme dëshirojnë të prodhojnë energji elektrike për përdorim vetanak.

Të dhënat e gjeoportalit për BRE-të

Gjeoportali i Kosovës është platformë publike që ofron të dhëna të rëndësishme për tokat, rrugët, lumenjtë dhe infrastrukturën tjetër kritike dhe zonat e mbrojtura në mbarë vendin, si dhe është mjet që mbështet zhvillimin e projekteve të reja për energji të ripërtërishme.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës (MMPHI) angazhoi një trupë praktikantësh, përmes programit për praktika "Energjia e re" të mbështetur nga USAID-i, për të mbledhur dhe përpunuar të dhëna gjeohapësinore që mundësojnë vendosjen e duhur të kapaciteteve për gjenerim të energjisë nga era dhe solaret. Të dhënat pastaj publikohen në një portal të qasshëm për të gjithë ata që kërkojnë informacion për aktivitetet zhvillimore për energji të ripërtërishme.

Grupi i të dhënave për energjinë solare është në dispozicion të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe do të publikohet si një shtresë e re në gjeoportalin e Kosovës. Grupet e të dhënave identifikojnë në mënyrë specifike se cilat zona ofrojnë rrezatimin më të mirë diellor dhe mund të përdoren për zhvillimin e impianteve solare FV. Pasi të identifikohet grupi i të dhënave për energjinë të erës, i njëjti informacion do të vihet në dispozicion publikisht për zhvilluesit e mundshëm.

Portali për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (Portali për BRE-të)

Kosova e ka prioritet modernizimin dhe përmirësimin e sektorit energjetik të vendit, dhe për t'i arritur këto objektiva të rëndësishme po punon nga afër me partnerët zhvillimorë, duke përfshirë USAID-in, Komisionin Evropian, KfW-në, Bankën Botërore, BERZH-in, GIZ-in, IFC-të, si dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë dhe nga sektori privat.

Zhvillimi dhe investimet e udhëhequra nga sektori privat, të mbështetura nga politika e shëndoshë e qeverisë dhe mjedisi nxitës për biznesin, janë me rëndësi kritike për zgjerimin dhe suksesin afatgjatë të dekarbonizimit dhe energjisë së ripërtërishme. Për t'i mbështetur investimet dhe zgjerimin e energjisë së ripërtërishme, Ministria e Ekonomisë po zhvillon **Portalin për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë** – www.reskosovo.com

Portali për BRE-të ofron një shërbim gjithëpërfshirës ku investitorët dhe zhvilluesit i gjejnë me një vend të gjitha mundësitë për energji të ripërtërishme në Kosovë. Portali ofron informacione të përditësuara rreth legjislacionit, rregulloreve dhe procedurat në fuqi, si dhe lidhje me akterët kyç të sektorit energjetik.



www.reskosovo.com



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

me.rks-gov.net